



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna e Istogut

Opština Istok

Istog Municipality

Komisioni komunal i Aksionarëve i "Stacioni i Autobusëve" në Istog, në bazë të dispozitave të nenit 16 të Ligjit nr.03/L87 për Ndërmarrjet Publike , shpall :

K O N K U R S

Titulli i vendit të punës: Drejtor në Bordin e Drejtorëve të "Stacioni i Autobusëve" në Istog.

Numri i pozitave: 4 (katër) kryerës .

Kohëzgjatja e mandatit: 3 (tri) vjeçare

Vendi i punës: Stacioni i Autobusëve në Istog

Paga: Kryesuesi i Bordit 120€, Anëtarët e Bordit 100 €

Detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve:

-Administron dhe ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze , në veçanti ,të veprimtarisë së zyrtarëve të N.P.L. dhe merr vendime për N.P.L."Stacioni i Autobusëve" sipas kompetencave të përcaktuara me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike.

-Zgjedh dhe e zëvendëson ,shkarkon Kryeshefin Ekzekutiv të N.P.L."Stacioni i Autobusëve".

-Aprovon Planin,Raportin e punës dhe Raportin Financiar të N.P.L."Stacioni i Autobusëve" në Istog për periudha të caktuara kohore dhe njëherë rekomandon për aprovim këto raporte tek K.K.A. dhe Kuvendi i Komunës.

-Miraton dokumentet si: Rregulloret e brendëshme, Skemen organizative dhe Sistematizimin e vendeve të punës etj.

-Propozon ndërmarrjen e hapave të ndryshëm për administrim sa më të mirë të N.L.P."Stacioni i Autobusëve".

-Për punën e vet Bordi i përgjigjet K.K.A. dhe Kuvendit të Komunës .

Shkollimi i kërkuar:

- Diplomë Universitare

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera :

- Të ketë së paku 5(pesë) vite përvojë – së paku në një nivel të lartë të menaxhmentit-në fushën e administrimit të biznesit ,financave kooperative, financa, menaxhim të thesarit ,banka ,konsulentë në biznes ose industri ose nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste në N.P. ose për së paku 5(pesë) vjet të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar ose anëtarë i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të N.P.

- Drejtori në bordin e Drejtorëve të N.P.L."Stacioni i Autobusëve" duhet të jetë person me

integritet të dëshmuar i cili i plotëson kushtet e parapara me dispozitat e nenit 17.1 dhe 17.2 të Ligjit nr.03/L-87 për Ndërmarrjet Publike.

-Të ketë shkathtësi menaxhuese,

-Të ketë njohuri për punë me kompjuter (MS,Word,Exel ,etj.)

-Njohja e gjuhëve zyrtare e domosdoshme.

Njohuria e gjuhëve të huaja dhe e punës me kompjuter do të konsiderohen si përparësi.

Kandidatët e interesuar për këtë pozitë, kërkesës duhet t'i bashkangjesin;

-C.V.

-Certifikatën e lindjes,

-Diplomën e përgatitjes shkollore.

-Dëshminë për përvojën e punës.

-certifikatën që nuk është nën hetime.

-Deklaratën me shkrim se i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 17.1 dhe 17.2 të Ligjit nr.03/L-87 për Ndërmarrjet Publike dhe

-Letër motivuese

Dokumentacioni i nevojshëm dorëzohet në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve të Komunës së Istogut ose përmes postës .

Konkursi është i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas shpalljes së Konkursit në mjetet e informimit publik.

Inkurajohen të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret kërkesat nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Istog, me 18.02.2016.

Komisioni Komunal i Akcionarëve

Nr.01nr.16/16